



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

---

**PROGRAM ORIENTUES PËR MATURËN SHTETËRORE**

**LËNDA:**

**GJUHË FRËNGE**

**PROVIM ME ZGJEDHJE (Niveli B2)**

**Koordinatorë: Erifili Hashorva**

**Viti shkollor 2014 – 2015**

**Tiranë  
Janar, 2015**

# 1. UDHËZUES I PËRGJITHSHËM PËR PROGRAMIN E PROVIMIT KOMBETAR TË MATURËS SHTETËRORE PËR LËNDËN E FRËNGJISHTES DHE PËR PËRDORIMIN E TIJ NGA MËSUESIT

Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në programet e gjuhës frënge, të cilat përcaktojnë njohuritë dhe shprehitë e domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale.

Programi orientues për përgatitjen dhe realizimin e provimit të Maturës Shtetërore për gjuhën frënge si lëndë me zgjedhje, është realizuar si sintezë e njohurive dhe shprehive të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë, si në aspektin tematik ashtu edhe në aspektin gjuhësor (gramatikor, leksikor) dhe funksional.

Niveli i njohurive i përket nivelit **B2** sipas dokumentit evropian “Kudri i Përbashkët Evropian i referencave për Gjuhët.

Ky program duhet të nxisë inspirim dhe sfida për të gjithë nxënësit dhe t’i përgatisë ata për të ardhmen. Programi Orientues është ndërtuar duke pasur parasysh nevojat e nxënësve si dhe zhvillimet e tyre personale.

## Synimet e programit

Me anë të këtij programi orientues synohet:

- Të ndihmojë nxënësin maturant në përgatitjen e tij për provimin e gjuhës frënge.
- Të ndihmojë mësuesin e gjuhës frënge në punën e tyre për zbatimin e programit dhe për t’u dhënë orientimet e duhura nxënësve.
- Të bëjë vlerësimin e dy aftësive kryesore (nga katër aftësi që ka gjuha e huaj), që janë: ***të lexuarit dhe të kuptuarit, si dhe të shprehurit me shkrim.***
- Të vlerësojë të kuptuarit dhe të shprehurit përmes strukturave bazë të gjuhës, si dhe aftësinë për përdorimin e gjuhës, duke përfshirë aspektin morfologjik, sintaksor, leksikor dhe funksional.
- Të japë orientime për specialistët që merren me hartimin e testeve të Maturës Shtetërore për gjuhën frënge si provim (lëndë) me zgjedhje.

- Të vlerësojë formimin e përgjithshëm kulturor, qytetar, social dhe gjuhësor përmes komunikimit të ideve me shkrim, duke respektuar rregullat e organizimit dhe shprehjes së ideve, mbështetur me argumenta dhe shembuj konkret.

### **Udhëzime praktike mbi përdorimin e programit**

Për përdorimin e këtij programi, mësuesi ka parasysh specifikën e gjuhës frënge, ku nxënësi në provimin me shkrim përballet me situata të reja ose me pjesë të reja leximi, por fusha tematike, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato që janë realizuar përmes programeve mësimore gjatë viteve të shkollës së mesme.

Mësuesi të kujdeset që nxënësit të përvetësojnë një sasi të gjerë e të konsiderueshme njohurish leksikore, që ngërthejnë në mënyrë përgjithësuese temat e përfshira në program. Kur flitet për **fushën tematike** (p.sh., les problèmes sociaux, l'environnement l'avenir), nuk do të thotë që në provim do të punohet i njëjti tekst që ndodhet në tekstin e punuar në shkollë. Do të zgjidhet një tekst i ri me të njëjtën fushë tematike, për të cilën nxënësi duhet të jetë në gjendje të përgjigjet.

Për sa i përket **njohurive gjuhësore (gramatika dhe fjalori)**, mësuesi i përgatit nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi aspektet kryesore gramatikore të përfshira në programet mësimore. Mësuesi duhet t'i vërë theksin anës praktike të zgjidhjes së ushtrimeve, duke i trajtuar këto ushtrime në forma të ndryshme, herë me tipe ushtrimesh me alternativa, e herë tipe ushtrimesh të hapura.

**Funksionet gjuhësore** Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës por duke ruajtur formatet dhe shprehjet që jepen në tekstet mësimore.

Përsa i përket të shkruarit mësuesi duhet të ushtrojë nxënësit e tij që të dinë të organizojnë me të tëra elementët forma të ndryshme eseje ose kompozimi jo letrar. Ata duhet të përgatiten që të ndërtojnë paragrafë të saktë nga ana strukturore dhe leksikore, dhe paragrafët në një njësi të unifikuar (ese' ose thjesht kompozim). Gjithashtu mësuesi duhet të përgatisë nxënësit që të jenë

të aftë të përmbledhin me shkrim një përvojë personale duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tij në një tekst koherent

## **2. Aftësitë dhe njohuritë që duhet të zotërojë nxënësi maturant për të qenë i përgatitur për provimin e maturës në gjuhën frënge.**

Nxënësi që i nënshtrohet provimit të Maturës Shtetërore në gjuhën frënge duhet të demonstrojë **aftësitë dhe njohuritë** e tij për sa më poshtë vijon:

### **2.1 Të kuptuarit përmes leximit (Compréhension écrite)**

Vlerësimi i këtij komponenti bëhet mbi bazën e një teksti të panjohur, mbi të cilin ndërtohen pyetje që vlerësojnë aftësinë e nxënësit për të kuptuar një pjesë letrare ose joletrare dhe për të gjykuar mbi të.

Programi orientues për përgatitjen e provimit të Maturës Shtetërore, i orienton nxënësit se si të përdorin aftësitë dhe strategjitë e të kuptuarit përmes leximit, të cilat janë zhvilluar në shkollën e mesme.

Më poshtë po radhisim disa aftësi të të kuptuarit përmes leximit:

- Përzgjedhja dhe marrja e informacionit të duhur nga teksti i dhënë.
- Reflektimi mbi përmbajtjen e një fragmenti dhe nxjerrja e informacionit të duhur prej tij.
- Paraqitja e elementeve provuese që mbështesin idenë e dhënë nga vetë nxënësi.
- Thellimi në kuptimin e një fraze dhe gjetja e sinonimit të saj.
- Formimi i një kuptimi të përgjithshëm dhe nxjerrja e moralit të pjesës.
- Zhvillimi i aftësisë krijuese dhe interpretuese dhe paraqitja e elementeve që justifikojnë përgjigjen e dhënë.
- Kuptimi i përgjithshëm i tekstit.
- Kuptimi i thelluar: gjetja e të pashprehurës ose të nënkuptuarës, qëndrimi i autorit etj.
- Plotësimi i ushtrimeve leksikore rreth tekstit.
- Gjetja e fjalëve referuese.
- Zgjidhja e ushtrimeve leksikore dhe gramatikore rreth tekstit.

## 2.2 Të shprehurit me shkrim (Expression écrite)

Në provimin e Maturës Shtetërore, nxënësi është i aftë të prodhojë tekste të shkruara mbi një gamë të gjerë fushash tematike. Nxënësi përgatitet të bëjë përshkrime të hollësishme mbi tema të njohura, të tregojë me shkrim përvojat e tij, duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tij, të përshkruajë një ngjarje, të tregojë një histori, të shkruajë një ese' mbi tema të ndryshme, të shkruajë një letër zyrtare, të bëjë komentin e një filmi, etj.

Për vlerësimin e kësaj aftësie, nxënësi paraqet një produkt të shkruar prej **120-150** fjalësh, ku të zhvillojë një temë mbi një çështje me interes të përgjithshëm.

Nxënësi vlerësohet për përmbajtjen, leksikun, korrektësinë gramatikore, strukturën e rrjedhën logjike.

Të shprehurit me shkrim përfshin:

- Të shprehurit me shkrim në formën e një eseje për një gamë të gjerë temash të njohura e komplekse që janë trajtuar ndër vite (ese' argumentuese, pro\ kundër dhe të japin zgjidhje problemit).
- Një produkt të shkruar saktë nga ana gramatikore dhe të strukturuar mirë (në formën e një letre zyrtare , të një letre aplikimi ose rekomandimi, si dhe artikuj të shkurtër).
- Shpjegimin e pikëpamjeve të ndryshme.
- Komente me shkrim për diskutimin e një filmi apo të një vepre letrare, një ngjarjeje, ose të një vendi turistik, apo të një objekti të kulturës.
- Përdorimi i konektorëve kohorë dhe llogjikë dhe strukturave të larmishme të fjalive

## 2.3. Njohuritë gjuhësore dhe leksikore

Në këtë program njohuritë kryesore që nxënësi ka marrë gjatë viteve të shkollës së mesme janë të dhëna përmes **fushës tematike** të mëposhtme, e cila është e ndarë në linja dhe nën-linja sipas tematikës së zhvilluar dhe **elementëve gramatikorë**, të cilët zhvillohen në mënyrë spirale gjatë viteve të shkollës së mesme dhe jepen të detajuara në program.

## Shprehitë

Shprehitë kryesore që nxënësi ka fituar në shkollën e mesme janë dhënë përmes akteve dhe funksioneve komunikative që përmban programi shkollor, përmes të cilit nxënësi aftësohet t'i ripërdorë në situata të reja e të larmishme komunikimi.

### Tipet e ushtrimeve të rekomanduara për çdo fushë

<p><b>Të kuptuarit me shkrim (Compréhension écrite)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- pyetje mbi përmbajtjen e tekstit,</li> <li>- ushtrime me plotësim të vendeve bosh,</li> <li>- ushtrime me disa zgjedhje, (choix multiples )</li> <li>- renditja e paragrafëve të ngatërruar, sipas logjikës dhe rrjedhës logjike,</li> <li>- gjetja e një informacioni në një tekst,</li> <li>- gjetja e idesë kryesore të një teksti,</li> <li>- gjetja e një informacioni nga tekste të ndryshme etj.</li> <li>- ushtrime ku i kërkohet paraqitja e elementeve provuese, që mbështesin idenë e dhënë nga vetë nxënësi</li> </ul>
<p style="text-align: center;"><b>Leksiku dhe gramatika (Lexique et grammaire)</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- ushtrime me zëvendësim,</li> <li>- ushtrime transformimi,</li> <li>- ushtrime me shumë zgjedhje,</li> <li>- ushtrime me plotësime vendesh bosh,</li> <li>- ushtrime me ndërtim fjalish,</li> <li>- bashkim fjalësh me kuptim, gjetje gabimesh, bashkim i funksionit me strukturën përkatëse,</li> <li>- gjetja e sinonimeve, antonimeve,</li> <li>- shprehja e të njëjtit kuptim me fjalë të tjera, parafrazime etj.</li> </ul>
<p style="text-align: center;"><b>Të shkruarit (l'expression écrite)</b></p>

- formulim pyetje/përgjigje,
- plotësim frazash,
- letër zyrtare,
- mesazh,
- radhitje paragrafësh sipas rrjedhës logjike,
- hartim me pika referimi,
- përmbledhje, koment,
- ese argumentuese, koment etj.

## Ndarja e peshës sipas fushave

<b>FUSHAT</b>	<b>Përqindja</b>
<b>Compréhension écrite</b> <b>Të Kuptuarit e një teksti të shkruar</b>	<b>40 %</b>
<b>Grammaire et Lexique</b> <b>Leksiku dhe gramatika</b>	<b>40 %</b>
<b>Production écrite</b> <b>Të shprehurit me shkrim (Të Shkruarit e nje eseje ose krijim, një letër, kërkesë, përshkrim, artikull, përmbledhje, etj.)</b>	<b>20 %</b>

### III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

#### Fushat tematike dhe leksiku

Kjo rubrikë e programit grupon linjat kryesore, si edhe nënlinjat, të cilat janë të zhvilluara në programin e shkollës së mesme. Ato reflektojnë ngushtësisht interesat e motivimin e nxënësve dhe rrokin gjithë sferën e marrëdhënieve *familje-shoqëri-nxënës*, sferën publike dhe sferën profesionale, si dhe aspektin kulturor e qytetërimin.

Përmbajtja tematike e programit është mbështetur në programin dhe tekstet shkollore të gjuhës frënge. Tematika e parashikuar për provimin e Maturës përfshin temat bazë sipas kurrikulës dhe programeve, si edhe nëntemat që gjenden në tekstet e gjuhës frënge që përdoren në shkollën e mesme.



### ***Kujdes!***

Duke pasur parasysh se shkollat e zhvillojnë mësimin me libra të ndryshëm, tematika është formuluar në mënyrë përgjithësuese dhe jo sipas titujve të mësimëve me të cilët nxënësit janë familjarizuar, por sigurisht përfshin të gjitha njohuritë e përvetësuara ndër vite përmes këtyre teksteve:

### **LE MONDE DU TRAVAIL**

- mes projets d'avenir
- les professions.

### **L'ÉCOLE ET L'ÉDUCATION**

- les relations entre les professeurs et les étudiants
- les activités scolaires: culturelles et sportives
- les échanges scolaires; les jumelages.

### **LES VOYAGES**

- les voyages touristiques et les échanges
- les vacances en famille et avec les copains
- les transports.

### **L'ENVIRONNEMENT**

- les paysages; la nature
- la pollution marine; la défense de la planète.

### **PRATIQUES CULTURELLES**

- la vie quotidienne,
- le mode de vie
- les goûts et les préférences
- la mode, la musique etc.

## **LES RELATIONS INTERPERSONNELLES**

- mes amis
- l'amour, la jalousie, la haine
- la surprise, l'indifférence
- les relations conflictuelles
- la force, la faiblesse,
- l'exploit et l'aventure.

## **CULTURE ET CIVILISATION**

- la mode, la publicité
- littérature; la musique; la peinture; les vedettes
- les échanges culturels: les jumelages.

## **LES MOYENS DE COMMUNICATION**

- les médias
- la presse
- la télévision
- le téléphone.

## **Leksiku**

Programi ka karakter tematik. Në bazë të temës, përzgjidhet dhe integrohet në të përmbajtja leksikore e domosdoshme, aktet gjuhësore, si dhe strukturat gramatikore që mundësojnë realizimin e kuptimit të teksteve të larmishme, si edhe të shprehurit me shkrim për tema të larmishme të njohura. Nxënësi duhet të zotërojë një repertor leksikor të mjaftueshëm për të përballuar me sukses kuptimin e dokumenteve në gjuhën frënge dhe për t'u shprehur lirshëm e saktë me shkrim.

## **Aktet dhe funksionet komunikative**

Propozohen aktet dhe funksionet e mëposhtme, që do të shërbejnë si mjete orientuese për nxënësit dhe hartuesit e tezës së provimit:

- Demander et donner des explications, des informations
- Donner et demander un avis, une opinion
- P.ex. je pense que, je crois que, il me semble que?
- Exprimer son accord ou son désaccord
- P.ex. je vous approuve sans réserve, je ne partage pas votre avis
- Raconter un évènement, exprimer la durée d'une action
- P.ex. Depuis..., ça fait... il y a... etc.
- Décrire les personnes ou les circonstances d'un évènement
- Raconter des actions habituelles ou une suite d'évènements au passé  
P.ex. d'habitude..., chaque matin + imparfait d'abord.. , après..., à la fin... et.
- Demander et donner des conseils ou des ordres
- P.ex. donne- lui son livre! Il ne fallait pas faire cela! Il faut que tu finisses vite!
- Exprimer la cause et la conséquence
- Etant donné que+ indicatif, à la suite de + nom..., à tel point que, si bien que +
- Indicatif...
- Exprimer l'opposition, la concession
- exprimer le but (pour + inf..., pour que + subjonctif)
- Comparer, exprimer la ressemblance et la différence
- p.sh. c'est pareil, c'est tout à fait différent, ça change et.
- Exprimer la condition et l'hypothèse
- Justifier une opinion ou une action
- Rapporter les paroles de quelqu'un.

### **Elementet dhe strukturat gramatikore**

Për një komunikim të saktë nga ana gramatikore me shkrim, sugjerohen strukturat dhe çështjet gramatikore si më poshtë:

## **Les modes et les temps verbaux**

### **L'indicatif**

- Le présent
- Le plus-que-parfait / l'imparfait/ le passé composé
- Le futur / le futur antérieur
- Le futur proche
- Le passé récent
- Les verbes irréguliers
- Les verbes pronominaux
- Le participe et ses accords
- La concordance des temps de l'indicatif

### **Le conditionnel**

- Le conditionnel présent
- Le conditionnel passé

### **Le subjonctif**

Le subjonctif présent

- L'utilisation de l'indicatif ou du subjonctif
- la phrase passive et la phrase active
- L'infinitif présent et passé
- Le gérondif / le participe passé
- L'impératif
- L'expression de la cause et de la conséquence
- L'expression du but
- L'expression de l'opposition et de la concession.
- Le discours direct / indirect.

## **Les articulateurs**

- Les articulateurs logiques.
- Les articulateurs temporels.

### **Les pronoms et les articles**

- Le complément d'objet direct
- Le complément d'objet indirect.
- La place des pronoms: ex. Je le lui donnerai
- Les pronoms: y et en
- Les pronoms relatifs simples et composés
- Les pronoms indéfinis
- Les pronoms et les adjectifs possessifs
- Les pronoms et les adjectifs démonstratifs
- La place, le nombre et le genre des adjectifs qualificatifs
- La nominalisation
- Les prépositions
- Les articles partitifs, définis, indéfinis, contractés